

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 3 dhe nenin 20, paragrafi (1), nënparagrafi 10<sup>1</sup> të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 41, paragrafi (6) nga Ligji i njëjtë, neni 15, paragrafi (1), nënparagrafi 3 dhe neni 39, paragrafi (1), nënparagrafi 10 të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.07.2019, për marrjen e vendimit pas Njoftimit për ndryshimin e strukturës së pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, nr.03/09 datë 12.09.2024 (PA1 nr.02-255 datë 13.09.2024), në pajtim me Konkluzionin e Këshillit ark.nr.02-3960/6 datë 30.09.2024, Këshilli I Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 37-të mbajtur më 30.09.2024, miratoi si vijon:

## V E N D I M

1. LEJOHET ndryshim në strukturën e pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, përkatësisht:

- për daljen e personit fizik [REDAKTUAR], me NVAQ [REDAKTUAR] dhe adresë në [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], me pjesëmarrje prej 100% të kapitalit kryesor të radiodifuzerit dhe

- për qasjen e personit fizik [REDAKTUAR], me NVAQ [REDAKTUAR] dhe adresë në rr., [REDAKTUAR] nr. [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], me pjesëmarrje prej 100% të kapitalit kryesor të radiodifuzerit.

2. Obligohet që Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, pas ndryshimit të kryer të cekur në pikën 1 të këtij Vendimi, drejtuar Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale të paraqesë gjendjen aktuale vijuese të dhënë nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit.

## A r s y e t i m

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, në pajtim me nenin 41 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV) dhe Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e njoftimit për ndryshimin e strukturës së pronësisë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.171/14), me Njoftim për ndryshimin e strukturës së pronësisë nr.03/09 datë 12.09.2024 (i yni PA1 nr.02-255 datë 13.09.2024), e njofton Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) për qëllimin e realizimit të ndryshimit të strukturës së pronësisë të SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë.

Njoftimi i dorëzuar për ndryshimin e strukturës së pronësisë nr.03/09 datë 12.09.2024 (PA1 nr.02-255 datë 13.09.2024), nga SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, është konstatuar se është e kompletuar dhe e rregullt, gjegjësisht i përmban të gjitha të dhënat dhe dokumentet e përcaktuara në Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e njoftimit për ndryshimin e strukturës së pronësisë.

Agjencia me qëllim për të shqyrtuar nëse me ndryshimet e propozuara të strukturës së pronësisë të SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë do të krijohet paligjshëm mediatik, gjegjësisht nëse janë në kundërshtim me ndalesat e neneve 34, 35 paragrafi (2) ose 38 të LSHMAAV, përmes Sistemit të shpërndarjes së internetit nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut (RMV-së), ka ofruar „Informacion për subjektet që lidhet (persona të autorizuar, bordet drejtuese, pronarë në subjekte të tjera) – gjendjen aktuale“, nr.0820-50/150020240319338, nr.0820-50/150020240319339 dhe nr.0820-

<sup>1</sup>Nënparagrafët 8 dhe 9 fshihen, shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.248/18).

50/150020240319340 të gjitha nga data 16.09.2024 nga e cila rezulton se personi [REDAKTUAR] figuron si pronar dhe drejtues i: Shoqërisë për bujtinari, tregti dhe shërbime DARDANIA-KËRÇOVË SHPKNJP eksport-import Kërçovë, ku aktiviteti prioritar/kodi kryesor i të ardhurave është 56.10 – Restorante dhe objekte të ngjajshme akomoduese për përgatitjen dhe shërbimin e ushqimeve, dhe të Shoqërisë për prodhimtari, tregti dhe shërbime SVISS RANÇ HOTEL-AGRO TURIZAM eksport-import SHPKNJP fsh. Karbunicë Kërçovë, ku aktiviteti prioritar/kodi kryesor i të ardhurave është 55.10 – Hotele dhe objekte të ngjajshme akomoduese. Personat juridikë të lartpërmendur nuk figurojnë si themelues të Shoqërive Tregtare.

Po ashtu, Agjencia ka bërë kontroll dhe në Regjistrin e pronarëve përfitues (të vërtetë) të mbajtur nga Regjistri Qendror i RMV-së, nga ku është ofruar dokumentacion për „Gjendjen vijuese të personit fizik – pronar përfitues“, nr.2007-50/150020240319341 datë 16.09.2024, e cila është e evidente se personi fizik [REDAKTUAR] është regjistruar si pronar i vetëm të dy personave juridik të lartpërmendur.

Pas ndryshimit të kryer të strukturës së pronësisë, pronar i vetëm i SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë do të jetë personi fizik [REDAKTUAR], me NVAQ [REDAKTUAR] dhe adresë në rr. „[REDAKTUAR]“ nr. [REDAKTUAR], me pjesëmarrje prej 100% në kapital kryesor të radiodifuzerit.

Duke pasur parasysh se Agjencia ka konstatuar se zbatimi i ndryshimit të strukturës së pronësisë të SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë nuk paraqet përqendrim të paligjshëm mediatik në kuptimin e LSHMAAV, gjegjësisht se ky ndryshim nuk është në kundërshtim me ndalesat e neneve 34, 35 paragrafi (2) dhe 38 nga Ligji i njëjtë, pas Njoftimit të dorëzuar për ndryshimin e strukturës së pronësisë nr.03/09 datë 12.09.2024 (PA1 nr.02-255 datë 13.09.2024), Këshilli i Agjencisë, miratoi vendim si në dispozitiv.

**Nr.02-255**  
**02.10.2024**  
**Shkup**

**Agjencia për Shërbime Mediatike**  
**Audio dhe Audiovizuale**  
**Kryetari i Këshillit,**  
**Lazo PETRUSHRVSKI, d.v.**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi radiodifuzeri, nëse është i pakënaqur me vendimin, ka të drejtë që në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të vendimit të paraqesë padi për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente.